

**“INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP” SH.P.K.**

**PASQYRA FINANCIARE TË VEÇANTA  
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur  
(Për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2020)  
( në Lekë)**

## PERMBAJTJA

Emertimi	Faqe
Raporti i audituesit të pavarur	1-2
Pasqyra e pozicionit financiar	3-4
Pasqyra e Performances	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	6
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto	7
Shenime për pasqyrat financiare	8-23



## Pasqyra e Pozicionit Financiar

Nr	A K T I V E T	Shenime	31.12.2020	31.12.2019
	<b>Aktivitet Afatshkurtra</b>			
	▶ <b>Aktivitet monetare</b>	5	<b>2,064,391</b>	<b>3,308,531</b>
	1 Banka		2,001,773	3,278,915
	2 Arka		62,618	29,616
	▶ <b>Investime</b>	6	<b>4,020,740</b>	<b>4,433,301</b>
	1 Huadhënie njësive ekonomike brenda grupit		0	0
	3 Huadhënie njësive ekon. ku ka interesa pjesëmarrëse		4,020,740	4,433,301
	▶ <b>Të drejta të arkëtueshme</b>		<b>1,141,998</b>	<b>10,144,693</b>
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit			
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit	7	0	2,157,210
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4 Të tjera	8	1,141,998	7,987,483
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar			
	▶ <b>Inventarët</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	6 AAGJM të mbajtura për shitje		0	0
<b>I</b>	<b>TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA</b>		<b>7,227,129</b>	<b>17,886,524</b>
	<b>Aktivitet Afatgjata</b>			
	▶ <b>Aktivitet financiare</b>		<b>1,816,258,027</b>	<b>1,789,272,602</b>
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	9	1,391,766,318	1,465,004,783
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit			
	3 Tituj pronësie në njësitë ekon. ku ka interesa pjesëmarrëse	10	65,998,413	60,600,000
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekon. ku ka interesa pjesëmarrëse	11	358,493,296	263,667,819
	▶ <b>Aktivitet materiale</b>	12	<b>8,930,951</b>	<b>10,843,406</b>
	1 Toka			
	2 Mjetet e transportit		8,206,954	10,258,692
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje		723,998	584,715
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces			
	▶ <b>Aktivitet afatgjata materiale të investuara</b>	12	<b>881,746,606</b>	<b>881,746,606</b>
<b>II</b>	<b>TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA</b>		<b>2,706,935,584</b>	<b>2,681,862,614</b>
	<b>AKTIVE TOTALE</b>		<b>2,714,162,713</b>	<b>2,699,749,138</b>

Shënimet shpjeguese nr. 1 -28, janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Financier

Stravrulla Gabi

Administrator

Grigor JOTI



## Pasqyra e Pozicionit Financiar

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	31.12.2020	31.12.2019
	► Detyrime afatshkurtra:		800,695	3,045,033
	1 Titujt e huamarrjes			
	2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
	3 Arkëtime në avancë për porosi			
	4 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13	184,566	228,634
	5 Dëftesa të pagueshme			
	6 Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit			
	7 Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	8 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shënde	14	558,825	687,344
	9 Të pagueshme për detyrimet tatimore	15	57,304	397,093
	10 Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut (intreresat e kred)	16	0	1,731,963
	► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	17	25,801	27,950
	► Të ardhura të shtyra			
	► Provizione			
	Totali i Detyrimeve afatshkurtra		826,496	3,072,983
	► Detyrime afatgjata:		914,847,168	1,747,730,000
	6 Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut	16	914,847,168	1,747,730,000
	► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
	► Të ardhura të shtyra			
	► Provizione:			
	1 Provizione për pensionet			
	2 Provizione të tjera			
	► Detyrime tatimore të shtyra			
	Totali i Detyrimeve afatgjata		914,847,168	1,747,730,000
I	DETYRIMET TOTALE		915,673,664	1,750,802,983
	► Kapitali dhe Rezervat			
	► Kapitali i Nënshkruar	18	100	100
	► Rezerva të tjera			
	3 Rezerva të tjera	19	948,946,055	
	► Fitimi i shpërndarë			
	► Fitim / Humbja e Vitit	25	849,542,894	948,946,055
II	Totali i Kapitalit		1,798,489,049	948,946,155
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,714,162,713	2,699,749,138

Shënimet shpjeguese nr. 1 -28, janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Financier  
Stravrulla Gabi

Administrator  
Grigor JOTI



## Pasqyra e Performancës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenime	Viti 2020	Viti 2019
		20	849,321,874	948,523,954
▶	Të ardhura nga aktiviteti			
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces			
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar			
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
▶	Shpenzime të personelit		-8,278,875	-7,232,197
	1 Paga dhe shpërblime		-7,489,721	-6,461,668
	2 Shpenzime të sigurimeve shoq/shëndetsore		-789,154	-770,529
	3 Te tjera personeli			
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		0	0
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	12	-2,189,954	-2,662,005
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	21	-4,850,401	-5,045,510
			15,867,879	18,963,270
▶	Të ardhura të tjera			
	1 Të ardhura nga interesat nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	22	15,590,380	18,370,661
	2 Të ardhura nga interesat nga njësitë e kontrolluara	22	0	508,709
	3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
	4 Te ardhura te tjera	23	277,499	83,900
▶	Shpenzime financiare	24	-228,435	-3,414,058
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)		-228,435	-3,424,890
	2 Te ardhura nga interesat bankare		0	10,832
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
▶	Fitimi/Humbja para tatimit	25	849,642,088	949,133,454
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-99,194	-187,399
	1 Shpenzimi i tatim fitimit	25	-99,194	-187,399
	2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë			
▶	Fitimi/Humbja e vitit	25	849,542,894	948,946,055

Shënimet shpjeguese nr.1 -28, janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Financier  
Stravulla Gabi

Administrator  
Grigor JOTI





**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
(metoda direkte)

Emertimi	Shenime	Viti 2020	Viti 2019
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>			
Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme		171,579	279,480
Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve	13&14	-11,305,106	-12,035,306
Pagesa të tjera		-269,901	-1,049,747
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>			
Interes i paguar	16	-1,731,963	-2,803,552
Tatim fitimi i paguar	8&15	-1,302,540	-178,361,254
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>-14,437,930</b>	<b>-193,970,379</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	12	-277,499	
Pagesa për blerjen e investimeve ne kapital	9&10		-76,600,000
Arkëtime nga zvogelim kapitali dhe shitje kuote	9&10	74,715,749	148,112,018
Dividendë të arkëtuara	20	850,484,725	1,217,181,856
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		<b>924,922,975</b>	<b>1,288,693,874</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar			
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral			
Hua të arkëtuara	11&16	312,372,395	2,361,934,472
Pagesa e huave	11&16	-1,240,128,080	-1,412,861,202
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare			
Interes i arketuar	6	16,002,941	24,252,075
Dividendë të paguar			-2,065,865,236
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		<b>-911,752,744</b>	<b>-1,092,539,891</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>		<b>-1,267,699</b>	<b>2,183,604</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>	5	<b>3,308,531</b>	<b>1,700,804</b>
Efëkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		23,559	-575,878
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	5	<b>2,064,391</b>	<b>3,308,531</b>

Shënimet shpjeguese nr.1 -28, janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Finançier  
Stravrulla Gabi

Administrator  
Grigor JOTI

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,662,304,365</b>	<b>0</b>	<b>583,201,437</b>	<b>2,245,505,802</b>
Zvogelim kapitali me burim fitimin neto	-1,662,304,265			- 1,662,304,265
Shperdarje fitimi			-583,201,437	- 583,201,437
Fitimi I vitit			948,946,055	948,946,055
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100</b>	<b>0</b>	<b>948,946,055</b>	<b>948,946,155</b>
Zvogelim kapitali me burim fitimin neto	0			-
Shperdarje fitimi		948,946,055	-948,946,055	-
Fitimi I vitit			849,542,894	849,542,894
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100</b>	<b>948,946,055</b>	<b>849,542,894</b>	<b>1,798,489,049</b>

Shënimet shpjeguese nr.1 -28, janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Financier  
 Stravrulla Gabi

Administrator  
 Grigor JOTI



## SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

### 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Investment Joti-Infosoft Group" sh.p.k është themeluar si shoqëri me përgjegjesi të kufizuar me date 17.02.2009 dhe është rregjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit me date 25 Shkurt 2009, me numer unik të identifikimit K91425022E.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti i veprimtarisë: Investime në shoqëri të kontrolluara dhe jo, veprimtari kreditimi dhe huamarrje, blerje, shitje dhe mbajtje në pronësi e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, etj konform statutit të shoqërisë.

Kapitali e regjistruar : me date 31.12.2020 është 100 LEKE (31.12.2019: 100 LEKE), i ndare në 2 kuota.

Kuotat e pronësive: Z. Grigor Joti, zoterues i 1 kuote që përben 80 % të kapitalit dhe Znj.Marjeta Joti zoteruese e 1 kuote që përben 20% të kapitalit.

Administrator: Z. Grigor Joti, me të drejta dhe detyra të percaktuara në statutin e shoqërisë dhe afat emërimi nga 01/04/2014 - 01/04/2024.

Adresa e selisë :Rruga "Murat Toptani", "Gjergji Center" në Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë të mara me qira.

Me datë 31 Dhjetor 2020 shoqëria kishte 8 punonjës (me 31 Dhjetor 2019 kishte 8 punonjës).

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK") për pasqyrat e veçanta, me qëllim plotësimin e kërkesave ligjore për raportimin financiar nga ana e shoqërisë.

Meqenëse SKK kërkojnë që shoqëria mëmë të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, këto pasqyra financiare të veçanta mund të mos jenë të përshtatshme për t'u përdorur si pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm, për të plotësuar kërkesat e gjithë përdoruesve të pasqyrave financiare. Pasqyrat e konsoliduara të Shoqërisë do të përgatiten në një datë të mëvonshme, pas miratimit dhe raportimit të pasqyrave të veçanta në administratën tatimore.

Shoqëria mban kontabilitetin dhe raporton pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 64 datë 22.07.2014 dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me efekt nga data 1 janar 2019.

#### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

#### 2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("LEKE"), e cila është monedha funksionale apo e mjedisit ekonomik kryesor, në të cilin vepron Shoqëria. Monedha e paraqitjes është Lek shqiptar ("LEKE"). Të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveçse ku shprehet ndryshe.

#### 2.4 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që Shoqëria ka burime dhe perspektivë për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.





### **Kompesimi (netimi)**

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëqoftëse është e drejte ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe ka një synim për t'i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim, dhe në mënyrë specifike në ndonjë nga politikat kontabël të Shoqërisë.

### **3. Gjykime të rëndësishme kontabel, vlerësime dhe supozime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

- (a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
- (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit dhe i zhvlerësimeve të aktiveve;
- (c) Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykim për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njih detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

### **4. Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara). Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me kosto historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëposhtëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare behet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivitet dhe pasivet e tjera duhet të referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.

Shoqëria "Investment Joti-Infosoft Group" sh.p.k është një shoqëri mëmë, e cila ka përgatitur këto pasqyra financiare të veçanta, konform me SKK-të, referuar paragrafit 56 të përshkruar në SKK 9. Për njohjen e investimeve të saj në njësitë e kontrolluara dhe në pjesëmarrje Shoqëria ka përdorur politikën kontabël : kosto minus zhvlerësimin.

### **Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato flukse që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shpendarja e fitimeve, nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.





## **Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat perkatese. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njesia ekonomike nuk prët përfitime të ardhshme, njihen menjehere në rezultatin financiar.

## **Intrumentat financiare**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njesie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njesie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njesite ekonomike pjesë e grupit, huamarrjet dhe huadheniet.

## **Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara me maturitet tre muaj ose më pak, të percaktuara si më sipër, e netuar me llogaritë e zbuluara bankare.

## **Aktivitetet financiare**

Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njesia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me koston e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njesia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Në këto raste janë përfshirë kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, hua si dhe kërkesa të tjera debitore, afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat në njohjen fillestare janë vlerësuar me vlerën e paskontuar apo me koston e transaksionit. Pas njohjes fillestare, aktivitetet financiare me koston të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktiviteti çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivitetet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktiviteti financiar që matet me koston ose me koston të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njesia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

## **Detyrimet financiare**

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, ortakëve për dividendë, hua dhe interesa, punonjesve, administratës tatimore, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me koston. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen me koston të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një aktiviteti financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivitetesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës perkatese.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë.





Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

**Kompensimi**

Aktivitet dhe Detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim ti shlyeje ato ne baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

**Detyrime/të drejta tatimore**

Si pjese e një aktivi apo detyrimi financiar, të drejtat dhe detyrimet tatimore përfshijnë të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të paguara dhe për tu paguar ndaj administrates tatimore, të cilat vleresohen me kosto (me vlerë të paskontuar). Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontojnë dhe nuk zhvleresohen.

**Aktive afatgjata materiale (AAM)**

Aktivitet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që përdoren nga njësi ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t'u dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, për më shumë se një periudhë kontabël. Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto dhe paraqiten në pasqyrat financiare me vlerë neto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka klasifikuar si aktive afatgjata materiale inventarët që përdoren për qëllime administrative dhe perbehen nga mjete transporti, pajisje informatike mobilje e pajisje zyre. Aktivitet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet normale për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM e shoqërisë, është metoda e vlerësimit mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar .

Normat vjetore të amortizimit të aplikuara janë si më poshtë vijon:

Pershkrimi	Norma vjetore	Metoda
Mjet transporti	20%	Me vlerë e mbetur
Pajisje informatike	25%	Me vlerë e mbetur
Mobilje e orendi	20%	Me vlerë e mbetur

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Tokat dhe Aktivitet në proces nuk amortizohen.

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontojnë flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

**Aktivitet afatgjata të investuara**

Aktivitet afatgjatë material i investuar është pasuria (tokë ose një ndërtesë ose një pjesë e ndërtesës, apo të dyja) e mbajtur nga pronari ose qiramarrësi sipas një kontrate qiraje financiare për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit ose të dyja, me përjashtim të rasteve kur:

(a) përdoret në prodhimin ose furnizimin e mallrave apo shërbimeve ose për qëllime administrative, ose





(b) shitet në rrjedhën e zakonshme të biznesit.

Një njësi ekonomike duhet të masë aktivin afatgjatë të investuar me koston e tij në njohjen fillestare.

Vlerësimi i mëpasshëm

Aktivi afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë të raportimit me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje. Një njësi ekonomike duhet të trajtojë të gjitha aktivet e tjera të investuara si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim. Shoqëria ka si aktive afatgjata investimi vetëm tokë, për të cilët nuk llogaritet amortizim. Jetëgjatesia dhe metoda e amortizimit për aktivet e amortizueshme, rishikohet çdo fund periudhe raportuese dhe rregullohet prospektivisht nëse është e nevojshme.

### **Provizionet**

Provizioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose kontraktual dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohej një dalje burimesh (përfitimet ekonomike) për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

### **Përfitimet e punonjësve**

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Gjatë ecuresë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

### **Kapitali**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga dy kuota e kapitalit të cilat përfaqësojnë kontributin e ortakëve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Kapitali njihet me kosto, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërisë.

### **Te ardhura të tjera dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në shoqëritë e grupit apo depozita bankare si dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). Të ardhurat nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto.

### **Tatimi mbi të ardhurat**

Tatim fitimi përbëhet nga taksa aktuale dhe e shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferencë të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimet e lidhura me atë takse do të





realizohen.

### Transaksionet ne valute te huaj

Regjistrimet kontabël të shoqërisë përgatiten në Lek (ALL), që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuar me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin. Kurset e këmbimit të përdorura për vlerësimin e gjendjeve në monedhe tjeter me date 31.12.2020 dhe 31.12.2019 janë:

<b>Monedha</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
EUR	123.7	121.77
USD	100.84	108.64

### 5. Mjete monetare dhe të ngjashme

Gjendjet e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten të detajuara si më poshtë:

<b>Likuiditete dhe vlera arke të tjera</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Para në arke	62,618	29,616
Llogari rrjedhese në banke LEK	1,361,857	1,674,173
Llogari rrjedhese në banke EUR	596,361	1,538,611
Llogari rrjedhese në banke USD	43,555	66,130
<b>Total mjete monetare</b>	<b>2,064,391</b>	<b>3,308,531</b>

Vlera e mesiperme përfaqëson vlerën e likuiditeteve me date 31.12.2020, gjendje në llogaritë që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në leke dhe valute si dhe gjendjen në arke. Gjendja e likuiditeteve (në banke) e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankes.

### 6. Huadhenie njesive ne pjesemarrje

<b>Huadhenie njesive ku ka interesa pjesemarrrese</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
<b>TOTAL</b>	<b>4,020,740</b>	<b>4,433,301</b>

Referuar kontratave respektive të huase, janë llogaritur dhe përfshirë në rezultatin financiar të vitit 2020 të ardhurat nga interesat e huase, në raport me kohën e përdorimit të huase.

**7. Te drejta te arketueshme nga njësitë ekonomike brenda grupit**

Te drejta te arketueshme	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
<b>TOTAL</b>	<u><b>0</b></u>	<u><b>2,157,210</b></u>

Ne kete rubrike eshte paraqitur kerkesa per tu arketuar gjate vitit 2020.

. nga fitimi i vitit 2018 i paarketuar

**8. Të drejta të arkëtueshme të tjera**

Të drejta të arkëtueshme të tjera	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
<b>TOTAL</b>	<u><b>1,141,998</b></u>	<u><b>7,987,483</b></u>

**9. Investime në shoqëritë e kontrolluara dhe në pjesëmarrje**

Investimet e shoqërisë “Investment Joti-Infosoft Group” sh.p.k. ne kapitalin e shoqërive te kontrolluara, brenda dhe jashte vendit me 31.12.2020 në total ishte 1,391,766,318 Leke, ndersa me 31.12.2019 ishte 1,465,004,783 Lekë. Ajo eshte ne rolin e shoqërisë kontrolluese, ne shoqëritë e listuara në vijim, pasi zoteron ne menyre te drejtperdrejte me shume se 50% te kapitalit të këtyre shoqërive:

Tituj pronësie ne njesite e kontrolluara	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
<b>TOTAL</b>	<u><b>1,391,766,318</b></u>	<u><b>1,465,004,783</b></u>

Shoqëria “Investment Joti-Infosoft Group” shpk, ka interesa jo-kontrolluese në shoqëritë e paraqitura në vijim (10), pasi zoteron në menyre te drejtperdrejte me pak se 50% te kapitalit te tyre. Investimet ne kapital jane vleresuar me kosto historike, minus ndonje zhvleresim te mundshem (kur ka).

**10. Investime në shoqëritë e kontrolluara dhe në pjesëmarrje**

Tituj pronësie ne njesite ku ka interesa pjesemarrëse	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
<b>TOTAL</b>	<u><b>65,998,413</b></u>	<u><b>60,600,000</b></u>

Në tabelën në vijim janë paraqitur investimet e shoqërisë në vlerë absolute dhe në %, në kapitalin e secilës nga shoqëritë e kontrolluara dhe në pjesëmarrjeme datë 31.12.2020 dhe me 31.12.2019 (shenimi nr.9 dhe 10):

**11. Tituj të huadhënies në njesitë ku ka interesa pjesëmarrëse**

<b>Huadhenie ne njesite ku ka interesa pjesemarrese</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
<b>TOTAL</b>	<b>358,493,296</b>	<b>263,667,819</b>

Referuar kontratës respektive të huasë, janë llogaritur dhe përfshirë në rezultatin financiar të vitit 2020 të ardhurat nga interesat e huasë, në raport me balancën dhe kohën e përdorimit të huasë. Interesat arkëtueshme me datë 31.12.2020 për këtë hua janë paraqitur në shenimin nr.6, si pjesë e të arkëtueshmeve afatshkurtra.

**12. Aktivët afatgjatë materiale**



**Shoqëria “Investment Joti - Infosoft Group” Sh.p.k.**  
Pasqyrat financiare të veçanta të vitit 2020

Aktive Afatgjata Materiale	Toke & Truall	Mjete Transporti	Te tjera	Total
<b>Kosto</b>				
<b>Gjendje 31.12.2018</b>	<b>1,023,796,020</b>	<b>29,306,891</b>	<b>822,100</b>	<b>1,053,925,011</b>
Shtesa			246,670	246,670
Pakesime				-
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>1,023,796,020</b>	<b>29,306,891</b>	<b>1,068,770</b>	<b>1,054,171,681</b>
Shtesa			277,499	277,499
Pakesime				-
<b>Gjendje 31.12.2020</b>	<b>1,023,796,020</b>	<b>29,306,891</b>	<b>1,346,269</b>	<b>1,054,449,180</b>
<b>Amortizimi</b>				
<b>Gjendje 31.12.2018</b>	-	(16,483,528)	(386,723)	(16,870,250)
Shtesa		(2,564,672)	(97,333)	(2,662,005)
Pakesime				-
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	-	(19,048,200)	(484,056)	(19,532,255)
Shtesa		(2,051,738)	(138,216)	(2,189,954)
Pakesime				-
<b>Gjendje 31.12.2020</b>	-	(21,099,938)	(622,272)	(21,722,209)
<b>Humbjet nga zhvlerësimi</b>				
<b>Gjendje 31.12.2018</b>	(142,049,414)	-	-	(142,049,414)
Shtesa				-
Pakesime				-
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	(142,049,414)	-	-	(142,049,414)
Shtesa				-
Pakesime				-
<b>Gjendje 31.12.2020</b>	(142,049,414)	-	-	(142,049,414)
<b>Vlera neto</b>				
<b>Vlera neto 31.12.2019</b>	<b>881,746,606</b>	<b>10,258,692</b>	<b>584,715</b>	<b>892,590,012</b>
<b>Vlera neto 31.12.2020</b>	<b>881,746,606</b>	<b>8,206,954</b>	<b>723,998</b>	<b>890,677,557</b>

Aktivitet afatgjata materiale janë prone e shoqërisë, janë dokumentuar në mënyrë të rregullt dhe priten përfitime ekonomike në të ardhmen. Në rubrikën Aktive afatgjata materiale të investuara është paraqitur vlera e Tokës, që me 31.12.2017 ishte klasifikuar si AAM ( inventar) për shitje. Pavarësisht pritshmërive pozitive, shoqëria nuk arriti të realizonte shitjen e saj, dhe si rezultat i planeve të saj për zhvillim, e riklasifikoi në AAM të investuara, duke e vlerësuar me vlerën më të ulët midis vlerës kontabël të mëparshme dhe shumës së rikuperueshme. Rregullimi i vlerësimit, në lidhje me këtë aktiv, është njohur në pasqyrën e performancës të periudhës kontabël viti 2018, në bazë të raportit të vlerësimit, të kryer nga Vlerësuesi i Licencuar me datë 19.12.2018.

### 13. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	31.12.2020	31.12.2019
Furnitore për shërbime	184,566	228,634
<b>TOTAL</b>	<b>184,566</b>	<b>228,634</b>

Shoqëria ka detyrime të pagueshme me 31.12.2020 sipas listës së furnitoreve, detyrime të cilat janë paguar në 2021.





**14. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqerore e shendetesore**

<b>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Paga	450,441	573,688
Sigurime Shoqerore e shendetesore	108,384	113,656
<b>TOTAL</b>	<b>558,825</b>	<b>687,344</b>

Detyrimet per paga dhe sigurimet shoqerore dhe shendetesore, perfaqesojne detyrime te muajit Dhjetor 2020, te paguara ne Janar 2021.

**15. Të pagueshme për detyrimet tatimore**

<b>Të pagueshme për detyrimet tatimore</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Shteti - Tatim mbi paga	57,304	81,137
Shteti - tatim ne burim	0	305,641
Shteti - tatim Fitimi	0	10,315
<b>TOTAL</b>	<b>57,304</b>	<b>397,093</b>

Detyrimet per tatim mbi paga perfaqeson detyrim te muajit Dhjetor 2020, i cili eshte paguar ne Janar 2021. Per llogaritjen e detyrimeve tatimore sipas shenimit 14 dhe 15, shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit “Per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore”, Per TVSH-ne”, per “Tatimin mbi te ardhurat” etj, te zbatueshme per aktivitetin e shoqerise.

**16. Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut**

<b>Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Hua nga ortakut ne leke	777,143,568	1,747,730,000
Hua nga ortakut ne euro	124,392,720	0
Hua nga ortakut ne usd	13,310,880	0
Detyrimet per interesat e kredise	0	1,731,963
<b>TOTAL</b>	<b>914,847,168</b>	<b>1,749,461,963</b>

Ne kete rubrike jane paraqitur detyrimet afatgjata të shoqerise ndaj ortakut. Huaja per vitin 2020 eshte trajtuar pa interes.

**17. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara**

<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Vodafone	25,801	27,950
<b>TOTAL</b>	<b>25,801</b>	<b>27,950</b>

Kjo vlere perfaqeson detyrimet ndaj Vodafone per shpenzime te konsumuara ne vitin 2020, por te faturuara ne vitin 2021.



**18. Kapitali**

<b>Kapitali i paguar</b>	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
Z. Grigor Joti (80%)	80	80
Zj.Marjeta Joti (20%)	20	20
<b>TOTAL</b>	<b><u>100</u></b>	<b><u>100</u></b>

Gjendja e kapitalit me date 31.12.2020 prej 100 Lekë, po aq sa ishte me 31.12.2019.

**19. Rezerva te tjera**

<b>Rezerva te tjera</b>	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
Rezerva nga fitimi i pashperndare	948,946,055	0
<b>TOTAL</b>	<b><u>948,946,055</u></b>	<b><u>0</u></b>

Referuar vendimit te asamblese se ortakeve nr.126 date 30.06.2020, eshte vendosuar qe fitimi i vitit 2019 te mos shperndahet, por te perdoret per te rritur rezervat e shoqerise.

**20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Gjate vitit 2020, Asambletë e Pergjithshme të Ortakëve të shoqërive të kontrolluara dhe në pjesëmarrje, kanë vendosur për shpërndarjen e fitimit (dividentëve), te cilat jane deklaruar nga shoqeria investuese "Investment Joti - Infosoft Group" sh.p.k., si të ardhura nga investimet financiare afatgjata, sikurse jane paraqitur në tabelën në vijim. Të gjitha këto të ardhura, me burim fitimin e realizuar nga shoqëritë e kontrolluara dhe në pjesëmarrje (pavarësisht formës shpërndarje fitimi, dividend) ne baze te neni 26 te ligjit nr. 8438 date 28.12.1998 i ndryshuar, janë konsideruar si të ardhura të perjashtuara nga tatim fitimi, pasi tatimi fitimi për këto të ardhura është mbajtur në burim, nga secila prej shoqërive, në kuadrin e deklarimit vjetor dhe pagesës së tatim fitimit nga këto shoqëri.

<b>Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Të ardhura nga shpërndarja fitimit nga shoq.të kontrolluara	692,271,364	808,455,307
Të ardhura nga shpërndarja fitimit nga shoq.në pjesëmarrje	157,050,510	140,068,646
<b>TOTAL</b>	<b><u>849,321,874</u></b>	<b><u>948,523,954</u></b>

**21. Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

Në tabelën në vijim janë paraqitur shpenzimet e kryera nga shoqëria në funksion të aktivitetit tregtar, të klasifikuara sipas natyrës.

<b>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</b>	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Energji elektrike	-21,692	-24,848
Blerje kancelari e shtypshkrim	-1,190	-13,696
Blerje dokumenta te tjera	0	-11,840
Qira GJC	-264,639	-263,238
Qira TD	-1,598,152	-1,591,539
Riparime,pjese kemb.automjetet	-1,407,891	-164,849
Mirembajtjeinformatike	-11,981	-44,827



**Shoqëria “Investment Joti - Infosoft Group” Sh.p.k.**  
Pasqyrat financiare të veçanta të vitit 2020

Mirembajtje e riparim godine	0	-54,000
Sherbim pastrimi	-27,540	-27,540
Siguracion,taksa per automjete	-48,215	-156,430
Sherb.kons.vler.prone	-27,000	-15,000
Noterizime,perkthime per dok	-35,108	-46,280
Paga ndermjetes honorare	-216,000	-180,000
Udhetime dieta jashte vendit	-289,569	-981,519
Vodafone	-306,616	-399,045
Shpenzime Postare	-4,907	-4,900
Karburanti per mjetet	-286,300	-544,900
Shpenzime per Domain IS Group	-7,871	0
Kom. bankare nisje transfertas	-119,898	-4,492
Kom. bankare per mbajtje lloga	0	-110,132
Komision ATM/Pos (B.Card)	-4,618	-10,552
Taksa e tokes	-19,936	-19,936
Takse pastrim Tabele Gjelber	-140,148	-67,000
Shpenzime pritje,percjellje	0	-14,022
Shpenzime per dhurata	-11,000	-136,137
Sponsorizime	0	0
Shpenz.jo te zbritshme	-130	-158,788
<b>TOTAL</b>	<b>-4,850,401</b>	<b>-5,045,510</b>

**22. Te ardhurat nga interesi**

<b>Interesa dhe të ardhura të tjera të ngjashme</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Interesa nga huate e dhena shoqerive te kontrolluara	0	508,709
Interesa nga huate e dhena shoqerive Int. Pjesemarrje	15,590,380	18,370,661
<b>TOTAL</b>	<b>15,590,380</b>	<b>18,879,370</b>

**23. Të ardhura te tjera**

<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Dhurata te marra	277,499	83,900
<b>TOTAL</b>	<b>277,499</b>	<b>83,900</b>





#### 24. Shpenzime interesi dhe të ngjashme

Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	Viti 2020	Viti 2019
Shpenzime interesi	0	-2,037,604
Te ardhura nga veprimet valutore	30,634	0
Humbje nga veprimet valutore	-259,069	-1,387,286
Interesa bankare	0	10,832
<b>TOTAL</b>	<b>-228,435</b>	<b>-3,414,058</b>

#### 25. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

<b>Fitimi bruto i ushtrimit</b>	<b>849,642,087</b>	<b>949,133,454</b>
Shpenzime te pazbritshme	341,083	639,825
Te ardhura te patatueshme	-849,321,874	-948,523,954
<b>Fitimi tatimor</b>	<b>661,296</b>	<b>1,249,325</b>
Humbje te mbartura	0	0
<b>Fitimi i tatueshem i ushtrimit</b>	<b>661,296</b>	<b>1,249,325</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-99,194	-187,399
<b>Fitimi neto</b>	<b>849,542,893</b>	<b>948,946,055</b>

Sikurse shihet nga tabela e mesiperme, te ardhurat e perjashtuara nga tatim fitimi, sikurse sqaruar në shënimin nr.20, jane me vlere 849,321,874 Leke (31.12.2019: 948,523,954 Lekë), jane të ardhura të tatuara per tatim fitimi në shoqëritë repektive ku është krijuar fitimi, ndërsa shpenzimet e panjohura janë në total 341,083 Leke (31.12.2019: 639,825 Leke). Nuk ka humbje të mbartura për vitin 2020. Bazuar në këto rregullime Fitimi i tatueshem i vitit rezulton 661,296 Leke (31.12.2019: 1,249,325 Leke) dhe shpenzimi per tatim fitimi per vitin 2020 është 99,194 Lekë (31.12.2019: 187,399 leke). Shoqëria rezulton me Tatim fitimi të mbipaguar shumën prej 6,685 Lekë paraqitur në shënimin nr.8 të pasqyrave financiare.

#### 26. Menaxhimi i rrezikut financiar

Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës se interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

#### Rreziku i tregut

##### 26.1 Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me EUR dhe USD. Shoqëria gjate vitit 2020 ka mitoruar rrezikun e kursit të këmbimit.

Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.





**Shoqëria "Investment Joti - Infosoft Group" Sh.p.k.**  
Pasqyrat financiare të veçanta të vitit 2020

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj në 31 Dhjetor 2020 është si më poshtë:

<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>LEK</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Total ne LEKE</b>
<b>AKTIVE</b>				
Kredi me interes dhe huadhenie	220,789,696	124,392,720	13,310,880	358,493,296
Investime financiare	1,439,531,852	18,232,879	-	1,457,764,731
Te drejta te arketueshme	-	-	-	-
Aktive te tjera	4,027,425	1,135,313	-	5,162,738
Tatim fitimi parapaguar	-	-	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente	1,424,475	596,361	43,555	2,064,391
<b>Total Aktive Financiare</b>	<b>1,665,773,447</b>	<b>144,357,273</b>	<b>13,354,435</b>	<b>1,823,485,156</b>
<b>DETYRIME</b>				
Kredi me interes dhe huamarrje	-	-	-	-
Kredi pa interes dhe huamarrje	777,143,568	124,392,720	13,310,880	914,847,168
Llogari te pagueshme	826,496	-	-	826,496
Te pagueshme te tjera	-	-	-	-
<b>Total Detyrime Financiare</b>	<b>777,970,064</b>	<b>124,392,720</b>	<b>13,310,880</b>	<b>915,673,664</b>
<b>pozicioni valutor neto</b>	<b>887,803,383</b>	<b>19,964,553</b>	<b>43,555</b>	<b>907,811,491</b>
<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>LEK</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Total ne LEKE</b>
<b>AKTIVE</b>				
Kredi me interes dhe huadhenie	268,101,120	-	-	268,101,120
Investime financiare	1,507,371,904	18,232,879	-	1,525,604,783
Te drejta te arketueshme	2,157,210	-	-	2,157,210
Aktive te tjera	6,852,170	1,135,313	-	7,987,483
Mjete monetare dhe ekuivalente	1,703,789	1,538,611	66,130	3,308,531
<b>Total Aktive Financiare</b>	<b>1,786,186,192</b>	<b>20,906,803</b>	<b>66,130</b>	<b>1,807,159,126</b>
<b>DETYRIME</b>				
Kredi me interes dhe huamarrje	1,749,461,963	-	-	1,749,461,963
Llogari te pagueshme	1,341,021	-	-	1,341,021
<b>Total Detyrime Financiare</b>	<b>1,750,802,983</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,750,802,983</b>
<b>pozicioni valutor neto</b>	<b>35,383,209</b>	<b>20,906,803</b>	<b>66,130</b>	<b>56,356,143</b>

Analiza e ndryshimit të përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korrigjim i vlerave të tyre i bërë për një 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlera pozitive/negative tregojnë rritje/ulje në fitim ose në kapital që ndodh kur leku dobësohet/forcohet në vlerën e tij kundrejt monedhave të huaja me +/- 10%. Kjo vlerë llogaritet si një përqindje mbi pozicionet neto, sipas valutave respektive, ku mbi pozicionet e vitit 2020 dhe 2019, efekti në rezultat llogaritet si vijon:

**Ndryshimi në Fitim /Humbjen e periudhes**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
EUR zhvleresohet /mbivleresohet me 10%	+/- 1,996,455	+/- 2,090,680
USD zhvleresohet /mbivleresohet me 10%	+/- 4,355	+/- 6,613

**26.2 Rreziku i kreditit**

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti.



## Shoqëria "Investment Joti - Infosoft Group" Sh.p.k.

Pasqyrat financiare të veçanta të vitit 2020

Shoqëria krijon një fond provigjoni për zhvlerësim i cili përfaqëson vlerësimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogarite e arkëtueshme bazuar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozime individualisht të rëndësishme. Në 31 Dhjetor 2020 nuk ka patur raste të zhvlerësimit të Aktiveve financiare, pasi janë të gjitha në afat, apo janë arketuar, deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është përfaqësuar nga vlerat kontabël të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përmbledhur si më poshtë:

<b>AKTIVE FINANCIARE</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Aktive financiare (investime në kapital)	1,457,764,731	1,525,604,783
Kredi me interes dhe huadhenie	65,998,413	263,667,819
Te drejta të arketueshme	0	2,157,210
Aktive të tjera	5,162,738	12,420,784
Tatim fitimi i parapaguar		0
Mjete monetare dhe të ngjashme	2,064,391	3,308,531
<b>TOTAL</b>	<b>1,530,990,273</b>	<b>1,807,159,126</b>

### 26.3 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria menaxhon nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e skeduluara të borxhit që rezultojnë nga detyrimet financiare si dhe parashikon hyrjet dhe daljet monetare në biznesin e përditshëm. Nevojat për likuiditet monitorohen në kohë të ndryshme. Kërkesat neto për para krahasohen me huamarrjet e disponueshme në mënyrë që të përcaktohet çdo mungesë. Kjo analizë tregon nëse huamarrjet e disponueshme priten të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës së vëzhguar. Me 31 Dhjetor 2020 dhe 2018 detyrimet e shoqërisë kanë maturitete kontraktuale (përfshirë pagesat e interesit kur aplikohen) si më poshtë:

<b>AKTIVE</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>			<b>31 Dhjetor 2019</b>		
	<b>&lt; 1 vit</b>	<b>&gt;1 vit</b>	<b>Totali</b>	<b>&lt; 1 vit</b>	<b>&gt;1 vit</b>	<b>Totali</b>
Aktive financiare (investime në kapital)	1,457,764,731		1,457,764,731		1,525,604,783	1,525,604,783
Kredi me interes dhe kompanive ku ka pronesi të kapitalit		358,493,296	358,493,296	0	268,101,120	268,101,120
Te drejta të arketueshme			0	2,157,210		2,157,210
Aktive të tjera	5,162,738		5,162,738	7,987,483		7,987,483
Tatim fitimi i parapaguar			0	0	0	0
Mjete monetare dhe të ngjashme	2,064,391		2,064,391	3,308,531		3,308,531
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>7,227,129</b>	<b>1,816,258,027</b>	<b>1,823,485,156</b>	<b>13,453,223</b>	<b>1,793,705,903</b>	<b>1,807,159,126</b>
<b>DETYRIMET</b>						
Huamarrje me interes			0	1,731,963	1,747,730,000	1,749,461,963
Kredi pa interes dhe huamarrje		914,847,168	914,847,168			0
Llogari të pagueshme	826,496		826,496	1,341,021		1,341,021
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>826,496</b>	<b>914,847,168</b>	<b>915,673,664</b>	<b>3,072,983</b>	<b>1,747,730,000</b>	<b>1,750,802,983</b>
<b>Hendeku-i Likuiditetit</b>	<b>6,400,633</b>	<b>901,410,859</b>	<b>907,811,491</b>	<b>10,380,240</b>	<b>45,975,903</b>	<b>56,356,143</b>
<b>Kumulative</b>	<b>6,400,633</b>	<b>907,811,491</b>	<b>907,811,491</b>	<b>10,380,240</b>	<b>56,356,143</b>	<b>56,356,143</b>

### 27. Palet e lidhura

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).

Më poshtë paraqiten balancat ndaj palëve të lidhura.





**Shoqëria “Investment Joti - Infosoft Group” Sh.p.k.**  
Pasqyrat financiare të veçanta të vitit 2020

Viti 2020	Aktive 31 Dhjetor 2020	Detyrime 31 Dhjetor 2020	Të ardhura viti 2020	Shpenzime viti 2020
Infosoft Systems sh.p.k.			420,010,713	
ITD sh.p.k.	362,514,036		65,953,734	
Infosoft Management Services sh.p.k.			2,107,108	15,962
Interbrands sh.p.k.			80,180,419	
InRE sh.p.k.			2,365,472	1,729,334
Inter Trade & Distribution sh.p.k.			154,910,007	
Inter Distribution Services sh.p.k.			71,425,508	
IMLS sh.p.k.			9,851,030	
ITD Prishtine sh.p.k.			32,697,645	
Infosoft Systems Prishtine sh.p.k.			25,760,618	
Grigor Joti		914,847,168		
InveG Sh.p.k.				291,873
<b>Total</b>	<b>362,514,036</b>	<b>914,847,168</b>	<b>865,262,254</b>	<b>2,037,169</b>

Viti 2019	Aktive 31 Dhjetor 2019	Detyrime 31 Dhjetor 2019	Të ardhura viti 2019	Shpenzime viti 2019
Infosoft Systems sh.p.k.	-	-	562,607,447	
ITD sh.p.k.	268,101,120		76,682,151	
Infosoft Management Services sh.p.k.	2,157,210		2,157,210	
Interbrands sh.p.k.			94,010,419	
InRE sh.p.k.			1,077,554	1,591,539
Inter Trade & Distribution sh.p.k.			119,444,319	
Inter Distribution Services sh.p.k.		15,965	77,076,630	
IMLS sh.p.k.			4,680,525	
ITD Prishtine sh.p.k.			25,188,478	
Infosoft Systems Prishtine sh.p.k.			4,478,589	
Grigor Joti		1,749,461,963		2,037,604
InveG Sh.p.k.				263,238
<b>Total</b>	<b>270,258,330</b>	<b>1,749,477,928</b>	<b>967,403,324</b>	<b>3,892,381</b>

**28. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare me datë 31.01.2021 nuk ka patur ngjarje të cilat të ndikonin në gjendjet e deklaruara nga shoqëria me datë 31.12.2020 dhe në shënimet shpjeguese të përfshira në këto pasqyra.

Pasqyrat financiare janë autorizuar nga administratori i shoqërisë me datë 10.02.2021.

**Financier**  
**Stavrulla GABI**

**Administrator**  
**Grigor JOTI**

